



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Marrëveshje e projektit


ndërmjet

Qeverisë së Republikës së Kosovës
përfaqësuar nga
Ministria e Drejtësisë (MD)

dhe

Qeverisë së Zvicrës
përfaqësuar nga
Departamenti Federativ i Punëve të Jashtme
përmes
Agjencia Zvicerance për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
("Palët")

Sa i përket projektit
Themelimi i Sistemit të Noterisë, Faza III



Në përpjekje për t'i forcuar marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy shteteve,

Në vazhden dhe zbatimin e Marrëveshjes Kornizë lidhur me Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndihmës Humanitare ndërmjet Këshillit Federativ Zviceran dhe Qeverisë së Kosovës, nënshkruar më 6 tetor, 2010 dhe në fuqi prej datës 16 dhjetor, 2010 (referuar më poshtë si "Marrëveshja Kornizë"),

Respektimin e parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut – siç parashtrohen veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut – të cilat i frymëzojnë politikat e jashtme dhe të brendshme të të dyja Palëve dhe përbëjnë një element thelbësor mbi baza të barabarta me objektivat e kësaj Marrëveshje,

Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë (referuar më poshtë si "MD") dhe Qeveria e Zvicrës e përfaqësuar nga Departamenti Federativ i Punëve të Jashtme, nëpërmjet Agjencisë Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim (referuar më poshtë si "SDC") janë dakorduar lidhur me termat dhe kushtet e përcaktuara si më poshtë:

Neni I

Definicione të përgjithshme

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje të projektit, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat vijuese kanë këto kuptime:

1. "SDC" nënkupton Agjencionin Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës. SDC mund të veprojë përmes Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (referuar më poshtë si "SCO-K"), e cila mund ta përfaqësojë atë në Kosovë

Neni II

Qëllimet dhe Objektivat

Kjo Marrëveshje e projektit siguron kornizën ligjore për kontributin e Qeverisë Zvicerane sa i përket projektit "Krijimi i një Sistemi Noteriel në Kosovë", faza III prej 01 mars 2012 deri më 31 dhjetor 2014 (referuar më poshtë si "Projekti". Kontributi i tillë sigurohet në përputhje me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe më saktësisht të MD.

Qëllimi i projektit është kontributi për zhvillimin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe në konsolidimin e sistemit gjyqësor. Rezultati i pritur i projektit është: një sistem noteriel i krijuar dhe funksional.

Faza e tretë e projektit do të ndahet në dy linja veprimi kryesore, të cilat dallojnë përnga shkalla e përgjegjësisë të cilën organizata implementuese (IHN) mund të mer sa i përket të arriturave (duke pasur parasysh përbërjen prej shumë akterësh të kësaj përpjekjeje për shtetndërtim dhe mësimet relevante të mësuara nga fazat e mëparshme).

Linja e Veprimit I: lidhet me lansimin e suksesshëm të shërbimit noterisë në 2012, këshillim të Asociacionit të Noterëve si dhe të grupit të parë të noterëve të licencuar dhe operativë në Kosovë. Ajo përfaqëson vazhdim logjik të fazës së dytë dhe konsolidimin e arritjeve zvicerane të realizuara deri më tani. Kontributi i Zvicrës për sistemin e noterisë atëherë do të konsistojnë në përgatitjen e brezit të parë të noterëve në Kosovë, dhe në përkrahje të krijimit të organizatës së tyre profesionale. Rezultatet dhe arritjet në linjën e veprimit I janë plotësisht brenda fushës së ndikimit të IHN, e cila mund të garantojë arritjet e saj (të paktën në një masë të madhe).

Linja e Veprimit II: ka të bëjë me zgjerimin e mëtejshëm të sistemit të noterisë: harmonizimi i kornizës ligjore, trajnimi dhe testimi i kandidatëve të tjerë për noterë, zhvillimin e kapaciteteve në divizionin e Noterisë në Ministrinë e Drejtësisë, etj. Rezultatet dhe aktivitetet në linjën e veprimit II varen shumë nga Ministria e Drejtësisë për shembull personeli adekuat në divizionin e Noterisë, veprime drejt testimit të kandidatëve të ri për noterë, harmonizimi i kuadrit ligjor etj. Në mesin e vitit 2013, do të bëhet vlerësimi afatmesëm i arritjeve dhe proceseve. Bazuar në këtë vlerësim, nga SDC do të merret një vendim për atë se a do të vazhdojë dhe si projekti zbatimin e linjës së veprimit II.

Neni III Detyrimet e SDC

1. SDC vë në dispozicion një grant prej maksimum CHF 1'000'000.—(një milion Franga Zvicerane) i cili do të përdoret ekskluzivisht për implementimin e projektit sipas qëllimeve dhe objektivave të përkufizuara më sipër në Nenin II.
2. Ky grant nuk mund të shfrytëzohet për kurrfarë qëllimi tjetër. Çdo pjesë e mbetur e grantit në fund të projektit duhet t'i kthehet SDC-së.
3. SDC kontraktton "Institut International des Hautes Etudes Notariales (referuar më poshtë si "IHN") për implementimin e projektit sipas projekt dokumentit Aneks I.
4. Granti do të transferohet dhe do të auditohet sipas dispozitave të kontratës ndërmjet SDC dhe partnerit të saj implementues.

Neni IV Detyrimet e MD

1. MD duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i siguruar lejet dhe miratimet e nevojshme për të mundësuar implementimin në kohë dhe efikas të këtij projekti.
2. MD do të kontribojë në krijimin e kontekstit të favorshëm për zhvillimin e sistemit të noterisë në Kosovë.
3. Me zbatimin e Marrëveshjes Kornizë, të gjitha mallërat dhe shërbimet që do të financohen nga SDC me këtë Marrëveshje të Projektit duhet të lirohen nga tatimet, në pajtim me nenet 5.1 dhe 5.2 të Marrëveshjes Kornizë.

Neni V Komunikimi, Mbikëqyrja dhe Koordinimi

1. SDC dhe MD duhet të identifikojnë secili një kontakt person i cili do të jetë person kontakti për Palën tjetër. SDC do ta konsultojë MD për të gjitha çështjet që kanë pasoja materiale për projektin. Gjithashtu, MD duhet të informojë SDC-në për çdo vendim ose zhvillim që ka pasoja për projektin. MD do të marrë pjesë në komitetin drejtues të projektit dhe SDC do të ftohet të marrë pjesë në diskutime të politikave dhe diskutime tjera të MD-së që kanë ndikim mbi projektin.
2. Komiteti Drejtues i projektit e mbikëqyr projektin në menyrë të rregullt. Ai përbëhet nga përfaqësues të MD, Asociacionit të Noterëve të Kosovës, USAID, si dhe nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë. Komiteti do të takohet dy herë në vit gjatë kohëzgjatjes së projektit për të monitoruar progresin e projektit.
3. MD do ta informojë SDC për çfarëdo financimi nga palë tjera për ndonjërin nga komponentat e përmendura të projektit.

Neni VI Prokurimi i mallërave dhe i shërbimeve

1. Mallërat dhe shërbimet që do të financohen nga mjetet e kontributit zviceran do të prokurohen në përputhje me Ligjin Zviceran për prokurim publik.
2. Gjatë kohëzgjatjes së projektit, mallërat e siguruar nga mjetet e SDC për përdorim të projektit do të mbetet në dispozicion të pakufizuar të projektit dhe nuk do të transferohen nga projekti pa miratim paraprak me shkrim nga SCO-K.

3. Nëse për ndonjë arsye projekti duhet të ndërpritet, do të vendoset me shkrim nga Palët për përdorimin e mallrave të ofruara me kontributin e Zvicrës. Në një rast të tillë, SDC nuk do të marrë asnjë përgjegjësi çfarëdo qoftë në lidhje me mallrat e përmendura.
4. Në fund të projektit, të dyja Palët do të bien dakord me shkrim për pronën dhe përdorimin e mallrave të prokuruar gjatë projektit.

Neni VII Antikorrupsioni

Brenda kornizës së kësaj Marrëveshje Projekti, Palët nuk do të propozojnë përfitime të cilësdo natyrë qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi. Ato nuk do të pranojnë kurrfarë propozimi të tillë. Çdo sjellje e korruptuar ose e paligjshme tregon shkelje të kësaj Marrëveshje të projektit dhe e arsyeton ndërprerjen e saj si dhe/ose ndërmarrjen e masave shtesë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.

Neni VIII Modifikimet

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj Marrëveshje të Projektit duhet të bëhet me shkrim dhe me pëlqimin e të dyja Palëve. Secila palë do ta marrë plotësisht në shqyrtim çdo propozim për ndryshim që bëhet nga Pala tjetër.

Article IX Ndërprerja

1. Secila Palë mund të përfundojë këtë Marrëveshje të projektit me anë të një lajmërimi paraprak prej 90 ditëve dërguar palës tjetër. Në rast të ngjarjeve të paparashikuara që pengojnë kryerjen e shërbimeve të dakorduara, secila Palë mund të përfundojë këtë Marrëveshje të projektit me efekt të menjëhershëm me anë të një lajmërimi me shkrim palës tjetër.
2. Nëse ngjarjet që rezultojnë nga ndonjë fuqi madhore (katastrofë natyrore, etj.) e parandalojnë zbatimin e Marrëveshjes së projektit, cilado nga Palët mund ta përfundojë Marrëveshjen me efekt që nga momenti kur bëhet e pamundshme që ajo të zbatohet.
3. Në rast të ndërprerjes së parakohshme të kësaj Marrëveshje të Projektit ose në fund të projektit, çdo pjesë e pashfrytëzuar e grantit të ofruar brenda kornizës së Projektit do t'i kthehet SDC.

Neni X Zgjidhja e kontesteve

Kontestet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes aktuale do të zgjidhen me negociata diplomatike mes palëve.

Neni XI Anekset

Dokumenti vijues i është bashkangjitur kësaj Marrëveshje të Projektit dhe përbën pjesë integrale të saj:



Aneksi 1: Dokumenti i programit: "Krijimi i Shërbimit të Noterisë në Kosovë" Faza III.

Neni XII
Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja aktuale e mbulon periudhën prej 01 Mars 2012 deri më 31 Dhjetor 2014.
Ajo hynë në fuqi me nënshkrimin e saj prej të dy palëve dhe mbaron me përmbushjen e obligimeve kontraktuale të të dy palëve.

Kjo marrëveshje është shkruar në 3 kopje origjinale, secila në anglisht dhe shqip. Në rast të dallimeve në interpretim, versioni në gjuhën angleze mbizotëron.

Palët e konfirmojnë dhe e nënshkruajnë këtë Marrëveshje të lidhur në Prishtinë më2012.

<p>Për Qeverinë Zvicerane</p>  <p>Markus Baschler Drejtor Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë</p>	<p>Për Qeverinë e Republikës së Kosovës</p>  <p>Hajredin Kuçi Ministër Ministria e Drejtësisë</p>
---	---